



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-924/15</u>
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum <u>27-03-2015</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.03.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-111/15, për z. Haxhi Mehmeti, Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinae Ambienti Sh.A, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Haxhi Mehmeti – Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinae Ambienti Sh.A dhe njëkohësisht, person i autorizuar në biznesin privat Ndërmarrja turistike transportuese dhe tregtare me shumicë dhe pakicë “Exim Tours”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Mehmeti është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se z. Mehmeti nuk ushtron më funksion publik, kjo është vërtetuar edhe me një shkresë zyrtare të pranuar nga Agjencia kundër Korrupsionit (DPKI-03-02/812/15).

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, zyrtari i lartë pas përfundimit të funksionit publik, mund të ushtrojë funksion menagjues në biznes privat, prandaj pushojnë hetimet për konflikt interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

